



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:160982

Datë: 11.08.2021

Numri i dokumentit: 02076713

P.nr.1024/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti Përgjithshëm-Divizioni Penal, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Adem Shabani, me e procesmbajtësen-praktikanten Anita Zefi, në çështjen penale kundër të pandehurit Sh.A., me vendbanim në fshatin Komuna Viti, për shkak të veprës penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës, nga neni 358 par 5 lidhur me paragrafi 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1460/20 të dt.01.12.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, në praninë e Prokurorit të shtetit Ardian Emini, të dëmtuarit B.A. dhe të pandehurit Sh.A. me përfaqësuesen e tij av.Vildane Hamiti, me datën 24.05.2021 deh vazhduar me datën 10.06.2021 me datën 16.06.2021 dhe me datën 23.06.2021, pas përfundimit të shqyrtimeve gjyqësore gjykata më dt.28.06.2021, publikisht ka shpallur, ndërsa me datë 08.07.2021, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **Sh.A.** me vendbanim në fshatin Komuna Viti i lindur me datë nga i ati, e ëma, e gjinisë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të përfunduar shkollën e mesme, me profesion tregtar, drejtor i shoqërisë tregtare “....” Sh.P.K në Ferizaj, i martuar , baba i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, mbrohet në liri,-

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

- me datë 29.06.2020 rreth orës 14:20, në fsh. Gërlicë K. Ferizaj, përkatësisht në depon ku bëhet grumbullimi i skrapit-hekurit të papërdorshëm së shoqërisë tregtare “....” Sh.P.K me numër biznesit , i pandehuri nga pakujdesia nuk ka vepruar në pajtim me nenin 20 par.1 nënpar.1.1 dhe nenin 23 par.1 të Ligjit nr. 04/l-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe me

këtë ka rrezikuar jetën e njerëzve, në atë mënyrë që i pandehuri në cilësi të punëdhënësit nuk është përkujdesur që secili i punësuar të trajnohet nga siguria dhe shëndeti në punë para ose pas themelimit të marrëdhënies së punës, si dhe lidhur me rastin konkret nuk e ka lajmëruar menjëherë Inspektorin e Punës, por ishin njoftuar nga Stacioni Policor Ferizaj, dhe si pasojë e mos trajnimit punëtori i kësaj ndërmarrje tani i dëmtuari B.A. së bashku me dy punëtorë të tjerë L.E. dhe F.D., gjatë çmontimit të një gome nga boshti i një bageri të papërdorshëm, ku e njëjta gomë pëlcet derisa boshti ishte në pozitën vertikale dhe bie mbi trupin e të dëmtuarit, me ç' rast e humb vetëdijen dhe për 17 ditë kishte qëndruar në gjendje kome në Klinikën e Anesteziologjisë dhe Mjekimit Intensiv-QKUK në Prishtinë, duke pësuar dëmtime të rënda trupore, dhe të rrezikshme për jetën në momentin e shkakimit, të përshkruar si në akt ekspertimin mjeko ligjor të Dr. M.G., të datës 21.11.2020, -

- me këtë ka kryer veprën penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par.5 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 38, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, dhe neneve 361, 365, 450 dhe 463 të KPPRK-së e

G J Y K O N

- Të pandehurit **Sh.A.**, i shqipton dënim burgimi me kusht në kohëzgjatje prej 6 / gjashtë / muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej një /1/ viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

- Obligohet i pandehuri të paguaj shpenzimet e procedurës penale për ekspertizën mjeko- ligjore shumë prej 20 Euro, dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, si dhe taksën në shumë prej 30 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- Obligohet i pandehuri të paguaj taksën në shumë prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit. në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- I dëmtuari B.A., nga fshati...., “.... “, Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1460/20 të dt.01.12.2020, ka ngarkuar të pandehurin Sh.A., me vendbanim në fshatin Komuna Viti, për shkak se ka kryer veprën penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par 5 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së.

Fjalën përfundimtare prokurori i shtetit Ardian Emini, e ka dorëzuar me shkrim gjykatës në vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor me datë 23.06.2021 dhe e ka lexuar ku ka theksuar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale që akuzohet i pandehuri, dhe pas administrimit të provave gjate shqyrtimeve gjyqësore vlerëson se është vërtetuar se i pandehuri e ka kryes veprën penale për të cilën është akuzuar si në dispozitiv të aktakuzës. Nga deklarimi i të pandehurit deklaratave të dëshmitarëve të dëmtuarit dhe provave të tjera që janë administruar në shqyrtimet gjyqësore, është vërtetuar pa asnjë dyshim dhe nuk është kontestuese se ditën kritike me datën 29.06.2020 rreth orës 13:40 në fshatin Gerlicë K. Ferizaj tek depoja e kompanisë “ ” i pandehuri Sh.A. si drejtor, punëdhënës dhe person përgjegjës i kësaj kompanie, nga pakujdesia nuk është përkujdesur për Sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtorëve dhe trajnimit adekuat të tyre nga Siguria dhe Shëndeti në punë dhe me këtë ka rrezikuar jetën e njerëzve- punëtorëve të tij e në rastin konkret ka rrezikuar jetën e të dëmtuarit B.A., i cili nga lëndimet e rënda të marra në vendin e tij të punës ka qëndruar 17 ditë në gjendje kome në Klinikën Intensive në Prishtinë. Se punëtorët nuk kanë qenë trajnuar dhe të certifikuar është vërtetuar nga dëshmitarja A.B., inspektore e punës e cila e ka përpiluar raportin zyrtar mbi aksidentin në punë i datës 31.08.2021, nr. protokollit 281/20 dhe se nga ky raport është vërtetuar se punëdhënësi konkretisht i pandehuri Sh.A., ka bërë shkelje të nenit 20 par.1 nën par.1.1 i ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në punë nr.04/L-161, pasi punëdhënësi ka qenë i obliguar që të përkujdeset që çdo i punësuar të trajnohet nga Siguria dhe Shëndeti në Punë për vendin e tij të punës me qëllim të shmangies së rreziqeve gjatë procesit të punës dhe që mos të angazhohet punonjës të cilët nuk kanë përvojë dhe njohurit e duhura duke marrë parasysh se i dëmtuari B.A., kishte vetëm 5 ditë pune në kompani para se të aksidentohej në vendin e tij të punës. Gjithashtu nga ky raport është konstatuar se punëdhënësi - i pandehuri Sh.A., nuk ka zbatuar dispozitën ligjore saktësisht të nenit 23 par.1 i ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë nr. 04/L-161 pasi që inspektorati i punës në Ferizaj lidhur me rastin e aksidentit në punë është i informuar me datë 29.06.2020 nga Policia e Kosovës dhe jo nga i pandehuri i cili kishte obligim ligjor ta njoftoj inspektoratin e punës lidhur me aksidentin në punë, po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se punëdhënësi i pandehuri Sh.A., ka bërë lëshime nga Ligji për Siguri dhe Shëndet në Punë ashtu siç i ka përshkruar në raportin e sipër cekur. Lidhur me pretendimet e të pandehurit dhe mbrojtëses së tij se punëtorët kanë trajnim për aftësimin e tyre për punë të sigurt ku kanë prezantuar një procesverbal të trajnimit të testimit të punëtorëve për punë të sigurt, i cili procesverbal nuk përmban as datë dhe kohëzgjatje të trajnimit dhe si e tillë kjo dëshmi nuk do të mund të merrej dhe administrohet si e tillë në shqyrtim gjyqësorë, pra nuk është certifikatë adekuate, ndërsa Ministria e Punëve dhe Mirëqenies Sociale dhe kompanitë e licencuara nga e njëjta kanë obligim ligjor që posa punëtori ta ketë përfunduar trajnimin përkatës duhet të lëshohet certifikata që ka të përfunduar trajnimin, mirëpo i njëjti i dëmtuari B.A., nuk posedon një të tillë edhe pse gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e posedon dhe se kjo certifikatë gjendet në kompani ku ka punuar “....”, por nuk ka arrit ta dëshmojë një gjë të tillë e njëjta certifikatë që do të përcaktonte kohën dhe datën e mbajtjes së këtij trajnimi ndërsa gjate shqyrtimit gjyqësor i pandehuri Sh.A., ka deklaruar se kompania e tij nuk lëshon certifikata për trajnime por se këto certifikata i lëshon kompania e licencuar “....”. Pas propozimit nga ana e prokurorit gjykata ka pranuar konfirmimin me datë 18.06.2021, me anë të cilës shkresë konfirmuese ku kanë konfirmuar se kompania e tyre pra kompania “....”, ka

bërë trajnimin e punëtorëve të kompanisë “ ” duke vërtetuar se i dëmtuari B.A., nuk ka qenë pjesëmarrës në trajnimin e organizuar nga ana e tyre dhe se i dëmtuari B.A., nuk posedon certifikatë mbi trajnimin për siguri në punë. Gjithashtu nga deklaratat e dëshmitareve – punëtorëve L.E. i cili në shqyrtimin gjyqësorë ka pohuar se nuk posedon një certifikatë për sigurinë në punë ndërsa dëshmitari F.D., edhe pse ka deklaruar se posedon certifikatë për siguri në punë nuk ka arrit ta siguroj dhe të njëjtën ta dëshmoj se e posedon. Nga të gjitha provat vërtetohet qartë se i pandehuri Sh.A., ka kryer veprën penale si ne dispozitiv të aktakuzës andaj i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj sanksion penal të paraparë me ligj i cili sanksion duhet të jetë adekuat me peshën dhe përgjegjësinë për këtë veprë penale.

Fjalën përfundimtare mbrojtësja e të pandehurit Sh.A., Av. Vildane Hamiti, e ka dorëzuar me shkrim në shqyrtimin gjyqësor me dt.23.06.2021 dhe të njëjtën e ka elaboruar ku ka theksuar se prokuroria ka ngritur aktakuzë për të mbrojturin Sh.A., për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par.5, lidhur me par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Prokuroria në dispozitivin e aktakuzës së saj thekson se i mbrojturi im ka kryer veprën penale duke vepruar në kundërshtim me nenin 20 par.1 nën par.1.1 dhe nenin 23 par.1 të Ligjit 04/L-161 Për Siguri dhe Shëndetin në Punë, pasi që në cilësinë e punëdhënësit nuk është përkujdesur që secili i punësuar të trajnohet nga Siguria dhe Shëndeti në Punë, para ose pas themelimit të marrëdhënies së punës si dhe lidhur me rastin konkret nuk e ka lajmëruar menjëherë Inspektoratin e Punës, por ishin njoftuar nga policia e Stacioni Policor në Ferizaj. Nga provat e administruara nga kjo gjykatë, nuk është vërtetuar se i mbrojturi im e ka kryer veprën penale siç e ngarkon Aktakuza andaj konsiderojmë se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mire se i pandehuri e ka kryer këtë veprë penale. Provat të cilat janë administruar nga kjo gjykatë janë tepër bindëse sidomos deklaratat e vet të dëmtuarit B.A., i cili në të gjitha fazat e kësaj procedure ka deklaruar se ka mbajtur trajnimin sipas ligjit dhe kjo vërtetohet me dëshminë e vetë të dëmtuarit të dhënë në Stacionin Policor me datë 03.09.2020 ,ku ka deklaruar se ditën e parë kur ka filluar punën ka mbajtur trajnim nga personi me emrin F...., i cili i ka treguar si të punoj, si të sillet në depo të kompanisë, pajisjet e punës që duhet ti kenë gjithmonë si kapelën, dorëzat dhe çizmet e punës. Po ashtu në deklaratën e tij të dhënë në prokurori më datë 12.01.2020 i dëmtuari në pyetjen e prokurorit të parashtruar se a keni mbajtur ndonjë trajnim lidhur me obligimet që jeni ngarkuar i dëmtuari është përgjigjur se po një ditë ka mbajtur trajnim nga njëri prej të punësuarve në këtë kompani i cili e ka emrin F...., aty është trajnuar dhe është udhëzuar se gjatë gjithë kohës së orarit të punës duhet ti ketë të veshura veshjet e punës si dhe mjetet mbrojtëse të punës kapelën, dorëzat si dhe udhëzimet e dhëna si të mbrohem nga rreziqet në punë. Ndërsa sipas procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 24.05.2021, në deklaratën e dhënë në Gjykatë i dëmtuari në pyetjen e prokurorit të shtetit ka deklaruar se është trajnuar për rreziqe që mund të paraqiten në punë nga personi me emrin F.K., i njëjti në të gjitha deklaratat e tij ka deklaruar se ka qenë i pajisur me mjete mbrojtëse për punë dhe se deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e “ pakujdesisë së tij ”, deklaratë të cilën e ka dhënë në polici më datë 03.09.2020 dhe e ka konfirmuar edhe në shqyrtimin gjyqësor të datës 24.05.2021. Gjykata po ashtu duhet t’ia falë besimin edhe deklaratave të dëshmitarit F.K., pasi që i njëjti ka qenë jashtëzakonisht i saktë dhe bindës kur deklaron se në

kompaninë e të pandehurit merret me shëndetin dhe sigurisë e punëtorit në punë dhe se e ka trajnuar punëtorin, të dëmtuari B.A., konform dispozitave të ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë respektivisht nenit 9 par.1 i cili përcakton se “ çdo punëdhënës është i detyruar të ngarkoj një ose më shumë të punësuar për të kryer aktivitete nga siguria dhe shëndeti në punë nëse nuk është përcaktuar ndryshe me këtë ligj ”. Po ashtu neni 10 par.1. dhe par.2 përcakton se “ Punëdhënësi ka të drejtë që vet të merr përgjegjësit për zbatimin e masave të përcaktuara me par.1 të nenit 9 të këtij ligji me kusht që ti plotësoj kriteret sipas paragrafit 5 të nenit 9, si dhe nenit 10 par.1 dhe 2 ku përcakton se punëdhënësi është i detyruar të caktoj një ekspert për kryerjen e detyrave të sigurisë në punë gjë që punëdhënësi në rastin konkret i pandehuri i ka plotësuar kushtet dhe kriteret sipas këtij ligji pasi që dëshmitari F.K. ka qenë i certifikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për të mbajtur trajnime në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, pra sipas kësaj del se Aktakuza është e pabazuar kur pretendon se i pandehuri nuk ka vepruar me nenin 20 par.1 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë pasi që nga deklaratat e të gjithë dëshmitarëve dhe të vetë të dëmtuarit vërtetohet e i pandehuri ka vepruar konform nenit 20 pa.1 të këtij Ligji i cili në mënyrë decisive kërkon trajnimin e punëtorëve me aktin e themelimit të marrëdhënies së punës mirëpo në asnjë dispozitë të këtij ligji nuk kërkohet që i trajnuari të pajiset me certifikatë. Andaj i propozojmë gjykatës që t'ia fat besimin këtyre deklaratave dhe të i'a fal besimin provës “ Procesverbal - Trajnim për aftësimin e punëtorëve për punë të sigurt ”, e cila është administruar si provë për arsye se e njëjta provë është marrë nga inspektorati i punës ditën e aksidentit dhe është provë reale sepse është nënshkruar nga vet i dëmtuari dhe trajnuesi F.K.. Gjykata duhet t'i fale besimin po ashtu edhe dëshmitarëve L.E. , I.R. dhe F.D. të cilët në seancën e datës 24.05.2021 kanë deklaruar se i dëmtuari B.A., ka qenë i pajisur me mjetet- veshjet mbrojtëse dhe se të gjithë punëtorët e po ashtu edhe i dëmtuari ka pasur trajnim për siguri dhe shëndet në punë. Sa i përket provave të kërkuara nga gjykata Kompanisë “ ”, edhe ne si mbrojtje e mbështesim këtë përgjigje pasi që e njëjta në përgjigjen e saj të datës 14.06.2021 ka theksuar se F.K., është i certifikuar si ekspert i SSHP - së dhe ka të drejtë të ushtroj aktivitetet e SSHP-së të cilën certifikatë e kemi administruar si provë ndërsa sa i përket kërkesës drejtuar “ ” se “ a është pajisur i dëmtuari B.A., me certifikatë mbi trajnimin “, ne si mbrojtje asnjëherë nuk kemi pretenduar se i dëmtuari B.A., ka certifikatë mbi trajnimin por ne qëndrojmë pas theksimeve të lartë cekura se i dëmtuari ka qenë i trajnuar dhe kjo vërtetohet me procesverbal- trajnim për aftësimin e punëtorëve për punë të sigurt, trajnim ky bërë në përputhje me dispozitat ligjore të lartë përmendura. Po ashtu i propozojmë gjykatës që dëshminë e të pandehurit Sh.A., ta merr si të besueshme pasi që dëshmia e tij ka qenë e sinqertë e bazuar në faktet dhe provat e administruara nga kjo gjykatë, ku i njëjti deklaron se deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e pakujdesisë së vetë të dëmtuarit, fakt të cilin e ka pranuar edhe i dëmtuari në deklaratën e dhënë në Stacionin Policor dhe këtë e ka konfirmuar edhe në gjykatë. Po ashtu i pandehuri është përgjigjur të gjitha nevojave dhe shpenzimeve të cilat i janë shkaktuar të dëmtuarit siç kërkon ligji. I propozojmë gjykatës që të mos ti fal besimin dëshmisë së dëshmitares A.B., pasi që e njëjta në shqyrtimin gjyqësor dëshminë e saj e ka pas të pa bazuar në provat dhe dispozitat ligjore të Ligjit mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë e sidomos kur deklaron që ky procesverbal nuk ka datë dhe vend ku është mbajtur, ku e njëjta nuk ka marrë parasysh që ky procesverbal- trajnim është nënshkruar nga vetë trajnuesi dhe i dëmtuari pas kryerjes së trajnimit asnjëherë nuk e ka kontestuar këtë fakt, e po ashtu për faktin se këtë provë e njëjta as

nuk e ka dorëzuar në prokurori së bashku me shkresat e tjera të lëndës siç ka deklaruar edhe vetë gjatë dëshmisë së dhënë në gjykatë. Gjithashtu sa i përket dispozitivit të aktakuzës se i mbrojturi im nuk ka vepruar konform nenin 23 par.1 të Ligjit mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, por pas deklaratave të dëshmitarëve është vërtetuar se menjëherë pas aksidentit punëtorët e kanë lajmëruar Qendrën Emergjente në Ferizaj dhe Policinë e Kosovës dhe arsyeja që nuk është lajmëruar Inspektorati i punës siç e kërko ligji ka ndodhur për shkak të mos dijës së punëtorëve të cilët e kanë lajmëruar Policinë, në vend të Inspektoratit duke menduar se së pari duhet lajmëruar policia pasi që siç dihet i pandehuri nuk ka qenë prezent në rastin e aksidentit, andaj nga gjykata kërkojmë që kundër të pandehurit Sh.A., të marr aktgjykim lirues, pasi që me asnjë provë të vetme nuk është provuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I pandehuri Sh.A. e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tijtë paraqitur me shkrim dhe elaboruar me gojë në shqyrtimin gjyqësor në tërësi pasi që nuk ekziston asnjë provë që e vërteton përgjegjësinë e tij se është kryes i veprës penale që e ka ngarkuar prokurori i shtetit dhe kërkon nga gjykata që në mungesë të provave për verën penale që akuzohet ta liroj nga përgjegjësia penale.

I dëmtuari B.A., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, dhe nuk parashtrohet kërkesë pasurore – juridike.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datën 06.01.2021, konform neneve 245 dhe 246 të KPPK-së ku të pandehurin Sh.A., e ka udhëzuar për të drejtat e tij dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, dhe i ka ofruar mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarojë i pafajshëm për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës, por i pandehuri është deklaruar i pafajshëm.

Pasi që i pandehuri Sh.A., nuk e ka pranuar fajësinë, gjykata e ka udhëzuar të pandehurin se para shqyrtimit të dytë mund të paraqes kundërshtim kundër provave të cekura në aktakuzë si dhe kërkesa për hedhjen e aktakuzës, këtë konform dispozitave ligjore të nenit 245 par. 5 dhe 6 dhe neneve 249 dhe 250 KPPK-së, dhe mbrojtësja e të pandehurit Sh.A. , av.Vildane Hamiti në afatin ligjor në gjykatë me datë 01.02.2021 ka parashtuar kërkesë për hedhjen e aktakuzës, ku gjykata një kopje të kundërshtimit i ka dërguar prokurorit të shtetit që të jep përgjigje me shkrim po nuk ka dhënë.

Gjykata jashtë seancës gjyqësore duke vepruar konform dispozitave të nenit 250 par. 3 të KPPK-se me datën 08.03.2021, ka sjell aktvendim dhe ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale kundër të pandehurit Sh.A., me vendbanim në fshatin Komuna Viti, i akuzuar sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1460/20 të dt.01.12.2020, për shkak të veprës penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par 5 lidhur me parag.2 të KPPK-së, por kundër aktvendimit palët nuk kanë ushtruar ankesë në afatin ligjor.

Gjykata Konform nenit 326 të KPPK-së me dt. dt.24.05.2021, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në prezencë të Prokurorit të shtetit Ardian Emini, të dëmtuarit B.A., të pandehurit Sh.A., dhe mbrojtëses se të tij me autorizim av.Vildane Hamiti, ku përsëri në fillim të shqyrtimit gjyqësor, ka ftuar të pandehurin Sh.A., të përcjellë me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor dhe e ka udhëzuar në kuptim të nenit 323 parag.2.1,2.2 dhe 2.3 të KPPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, dhe udhëzimeve të pandehurit me të drejtat ligjore i pandehuri Sh.A., u deklarua se e ka kuptua aktakuzën për veprën penale që akuzohet dhe është konsultuar me mbrojtësen e tij dhe se nuk ka nevojë për sqarime shtesë, të njëjtit ju ofrua mundësia serish të deklarohet për fajësinë apo pafajësinë, i njoftuar serish me kushtet, pasojat dhe privilegjet e pranimit të fajësisë, por i pandehuri është deklaruar i pafajshëm.

Pasi i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka ftuar prokurorin e shtetit, të dëmtuarin dhe mbrojtësen e të pandehurit të paraqesin fjalën hyrëse konform nenit 328 par 1. të KPPK-së, të cilët e kanë paraqitur.

Konform nenit 329 gjykata ka bërë prezantimin e provave që i ka konsideruar të rëndësishme për një gjykim të saktë dhe të drejtë.

I dëmtuari B.A., gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se në polici dhe prokurori ka dhënë deklaratë lidhur me atë që i ka ndodhur dhe në vazhdim ka theksuar se është vërtetuar se me datë 25.06.2020, është punësuar në pozitën e punëtorit fizik në ndërmarrjen “ ”, ku kishte nënshkruar kontratën e punës, por nuk kishte pasur ndonjë punë të specifikuar por sipas nevojës si për mirëmbajtje, pastrim dhe të tjera. Tutje, shton se një ditë kishte mbajtur trajnim nga njëri prej të punësuarve në këtë kompani i cili quhet F.K. ndërsa mbiemrin e tij nuk ia di, aty ishte trajnuar se duhet gjatë gjithë kohës t’i kemi veshjet e punës si dhe mjetet mbrojtëse të punës kapelën, dorëzat si dhe si të mbrohem nga rreziqet në punë, po ashtu në objektin ku jam punësuar janë të vendosur të gjitha pajisjet e sigurisë. Ndërsa sa i përket ditës kritike, të datës 29.06.2020, thekson se kishte qenë duke punuar në vend punishten e kompanisë “ ” saktësisht tek “....”, ku aty kishte qenë së bashku me dy punëtorë të tjerë F.D. dhe L.E., dhe kishin shkuar që të çmontojnë një gomë ku goma ka qenë e madhe, ka qenë gomë e bagerit, ku së bashku me boshtin e vet përafërsisht ka mund të peshoj diku 600 kg, ku në ditën kritike kemi pasur për detyrë, së bashku me kolegët që i përmenda, që këtë gomë ta heqim nga boshti i saj, mirëpo për shkak të asaj që më ka ndodhur mua, pra nga aksidenti saktësisht nga goditja që kam pësuar nga goma në pjesë të ndryshme të trupit nuk më kujtohet saktë se çka ka ndodhur, ngase e kam humbur vetëdijen dhe 17 ditë kam qëndruar në gjendje kome, në klinikën intensive në QKUK – Prishtinë, por sipas asaj që më kanë treguar shokët atë ditë derisa kemi qenë duke e larguar gomën, më kanë thënë se gjatë çmontimit goma ka pëlçitur dhe në atë moment derisa ishte në pozitën vertikale ajo është kthyer mbi mua më ka goditur duke më nxënë përfund dhe nga ai moment mua më ka humbur vetëdija dhe nuk më kujtohet asgjë se çka ka ndodhur. Po ashtu deklaron se pas shërimit, kishte kuptuar se kishte pësuar lëndime në kokë, në brinjë ku kishte pasur fraktura-thyerje, në këmbë, ku këmbën e majtë e kam pasur të zhvendosur- të nxjerrë nga vendi si dhe gjurin e këmbës të majtë si dhe për shkak të lëndimit

të brinjëve edhe mushkëritë i kam pasur të dëmtuara, mirëpo tani e kishte ndërprerë terapinë mjekësore dhe sipas analizave dhe kontroleve që kam kryer mjeku më ka thënë që tani jam shëruar dhe nuk kam pasoja shëndetësore. Gjithashtu i dëmtuari-dëshmitari deklaroi se të gjitha shpenzimet e mia mjekësore i ka mbuluar kompania konkretisht pronarët e kësaj kompanie Sh.A. dhe H.R. e po ashtu të njëjtit nuk më kanë ndërprerë pagën dhe prej ditës kur ka ndodhur aksidenti kam marrë rrogë të plotë, po ashtu të njëjtit më kanë thënë që për çdo mjekim që kam nevojë do të mbulojnë shpenzimet, ndërsa sa i përket vizitave nuk i kanë lejuar të më vizitojnë për shkak të situatës me pandemi, si dhe nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale për të njëjtit si dhe nuk parashtron kërkesën për kompensim të dëmit që më është shkaktuar, sepse siç e thash më herët të gjitha shpenzimet mi kanë mbuluar.

Dëshmitari I.R., në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se punon në Kompaninë “ ” dhe atë me detyrë të punës si kryepunëtor rreth 5 vite, ku detyrat e tija janë që t’i jep detyrë secilit punëtor për punën që ka në bazë të kontratës si dhe sigurimin e pajisjeve mbrojtëse sipas punëve që i kryen, e përcjellë punën e tyre me ditarë pune, pra i cakton detyrat ditore brenda kompanisë. Palën që është prezent në shqyrtimin gjyqësor në cilësinë e të dëmtuarit e njeh pasi që ka qenë punëtor në Kompaninë “ ” dhe para se punëtorët të lidhin kontrata çdo herë mbajnë trajnime lidhur me masat për siguri në punë ku për këtë edhe B.A. ka mbajtur këtë trajnim ku këtë trajnim e ka mbajtur F.K.. Me datën 29.06.2020 ka qenë në punë, në ditën kur ka ndodh aksidenti i ka thënë B.A. që të shkon dhe t’i ndihmon punëtorëve F.D. dhe L.E., ndërsa sa i përket lëshimit të certifikatës nuk ka njohuri, gjithashtu edhe për trajnimet që i ka mbajtur besoj që e ka marrë certifikatë pasi që çdo trajnim që mbahet duhet më pas të jepet certifikata, por nuk më kujtohet që a është pajisur punëtori B.A., me certifikatë të trajnimit. Me datën 29.06.2020, tek vendi ngjarjes nuk ka qenë por siç e kanë njoftuar punëtorët i kanë treguar se duke e hequr nga boshti i bagerit një gomë, është dëmtuar punëtori B.A. dhe i njëjti është dërguar në Qendrën Emergjente në Ferizaj për ofrimin e ndihmës mjekësore. Si kryepunëtor për secilin punëtor sipas kontratës së punës që i kryen brenda kompanisë “ ” kujdeset për sigurimin e pajisjeve mbrojtëse, ku në ditën kritike të gjithë punëtorët kanë qenë të pajisur me mjete mbrojtëse, po ashtu edhe B.A., ka qenë i pajisur me të gjithë mjete mbrojtëse ku ka pasur këpucët, rrobat e punës, helmetën, dorezat si dhe syzet. Është hera e parë prej se punon në këtë kompani që i’u ka ndodhur ndonjë rast që ka pësuar lëndime ndonjë punëtorë, pra është hera e parë që ka ndodhur ky rast me punëtorin B.A. ku menjëherë i kanë lajmëruar policinë, ekipet emergjente, kurse sa i përket inspektoratit nuk i kujtohet që i kanë lajmëruar, por nga trajnimet n’a kanë njoftuar që duhet të thirret edhe inspektorati në këto raste.

Dëshmitari L.E., në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se punon në kompaninë “ ” afër dy vite, me detyrat e tij të punës punëtor fizik por sipas nevojës kryen edhe detyra tjera të punës, me të dëmtuarin B.A., janë fqinjë, por para se të filloj të punoj në kompaninë “ ” ata kanë mbajtur edhe trajnim për detyrat dhe përgjegjësitë dhe sigurinë në punë. Në vazhdim të shqyrtimit gjyqësorë me lejen e gjykatës prokurori i shtetit bënë ballafaqimin me deklaratën e dhënë në Polici me datën 29.06.2020 si dhe qëndron pranë kësaj deklaratë dhe e mbështet në tërësi, dhe është e vërtetë se për punën që kryejnë në kompani punëtorët kanë mbajtur trajnim dhe këtë trajnim e ka mbajtur F.K., ky trajnim se sa ka zgjatur nuk e din, kanë mbajtur trajnim por certifikatë nuk kanë pranuar me shkrim, qëllimi i trajnimit ka qenë që t’i njoftoj për

sigurinë dhe ruajtjen e shëndetit në vendin e punës, të ikjes nga rreziku nëse paraqitet gjatë punës, përdorimin dhe vendosjen e pajisjeve etj. ku detyrat i pranon nga menaxheri I.R.. Në ditën kritike ka qenë në vend të punës, me datën 29.06.2020 I.R. i ka urdhëruar që të shkojnë tek vendi i punës për të bërë çmontimin e një gome nga boshti i bagerit aty kemi shkuar unë, dhe kolegët F.K.i dhe B..., ku me vete kemi pasur pajisje të punës dhe atë dorezat, helmetën, rrobat, këpucët, syzet dhe përveç helmetës të gjitha tjerat i kanë pasur të vendosura, por nuk kanë pasur njoftime apo udhëzime nga Iliri pasi që unë e kam vlerësuar se nuk do parqet ndonjë rrezik, ku me herët kanë hequr goma të llojit të njëjtit por nuk kemi pasur problem, kemi filluar të çmontojmë gomën për një moment ka pëlçitur goma dhe ka ra drejt kolegut B.A. , ku kemi larguar gomën nga trupi i B...., kemi lajmëruar policinë e më pas Qendrën Emergjente dhe në një afat shumë të shkurt kanë ardhur në vend të ngjarjes, unë dhe F.... nuk kemi marr lëndim përveç B..., I.R. nuk ka qenë në vendin e ngjarjes në atë moment, Iliri ka qenë në punë në ditën kritike dhe është njoftuar pasi ka ndodhur rasti dhe me pas e kanë thirr Ilirin ka ardhur pasi që i njëjti ishte brenda kompanisë.

Dëshmitari F.D., në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se punon në firmën “ ” rreth 4 vite me pozitë të punës punëtor fizik , kompania mban trajnime të punëtorëve për siguri në punë ku edhe unë kam mbajtur trajnim nga F.K., por trajnimin e fundit nuk më kujtohet kur e kam mbajtur ndoshta para një viti. Në trajnim kanë qenë Iliri dhe Lirimi , ku F.K. në trajnim ka shpjeguar lidhur me rregullat e punës, pajisjet për punë dhe jam pajisur me certifikatë dhe me vete nuk e kam por e kam në shtëpi. Me datën 29.06.2020 kam qenë në vend të punës, në ditën kritike kam marr pjesë edhe unë në çmontimin e gomës dhe gjatë çmontimit kam vërejtur se disa siguresa kanë dalë nga goma dhe kanë shkuar në drejtim të kolegut B.... ku ka marr lëndime, dhe për lëndimet e pësuar e kemi lajmëruar kolegun Ilir ku menjëherë ka marr veprime, ka thirr policinë, Emergjencën, I.... ka qenë në punë por nuk ka qenë prezent në vendngjarje, nga koha që punoj unë në këtë kompani është hera e parë që ka ndodhur një rast i tillë, por në kemi qenë të pajisur me të gjitha pajisjet e domosdoshme që duhet t'i këtë një punëtor.

Dëshmitarja A.B., Inspektore e punës në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se detyrat e punës në bazë të kontratës që ka nënshkruar janë se si inspektore e punës i inspekton punëtorët në vendin e punës, kur ti ndodhë në kompani ndonjë rast kur lëndohet ndonjë punëtor, punëdhënësi është i detyruar ose i obliguar sipas neni 23 të ligjit për Siguri dhe Shëndetin në Punë 04L-161 ti njofton për rastin që i ndodhë. Për rastin konkret për punëtorin që është lënduar në vend të punës nuk janë njoftuar nga punëdhënësi por njoftimin e kanë marr nga policia, ku se bashku me kolegun e punës K.Sh., kanë shkuar në vend të ngjarjes kanë bërë fotografimin e mjetit me të cilin është lënduar personi kanë marr emrat e dëshmitarëve që kanë qenë prezent, pasi që të njëjtin në vendin e ngjarjes nuk kanë dhënë dëshmi për shkak të shqetësimit nga ngjarja dhe janë ftuar të japin deklarata në inspektorat, kurse punëtori i lënduar B.A., ishte dërguar në emergjencë për trajtim. Për rastin konkret, nga punëdhënësi ka pas lëshime sepse punëtori i cili ka marr lëndime në këtë aksident nuk ka qenë i trajnuar nga Siguria dhe Shëndeti në Pune, sepse në bazë të nenit 20 të ligjit të lartcekur par.1 nën par. 1.1 thuhet: *“ punëdhënësi është i obliguar që secili i punësuar të trajnohet nga siguria dhe shëndeti në punë nga kompanitë e*

licencuara, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale varet prej specifikave të punës’’, pra punëdhënësi është dashtë që punëtorët të cilët kanë themeluar marrëdhënie pune të trajnohen për siguri dhe shëndet në punë për vendin përkatës të punës për rastin konkret punëdhënësi nuk e ka trajnuar punëtorin që ka marr lëndime nuk ka qenë i trajnuar. Në pyetjen e parashtruar nga mbrojtësja e të pandehurit se a i keni dorëzuar prokurorisë së shtetit së bashku me shkresat e lëndës këtë procesverbal që e keni përmendur në shkresat e lëndës, dëshmitarja deklaron se prokuroria nuk i ka kërkuar dosje, por unë e posedoj këtë procesverbal në lëndë, e që është i njëjti që po ma prezanton në seancën e sotme gjyqësore mbrojtësja e të pandehurit. Ne vazhdim mbrojtësja e e pandehurit i parashtron pyetje dëshmitares se kompania ‘’ NN ‘’ ‘’ a është e licencuar për vlerësimin e rrezikut në vendin e punës, ku dëshmitarja është përgjigjur se kompania është e licencuar ,por nuk posedoj certifikatë të personit i cili është trajnuar, në rastin konkret i dëmtuari.

Dëshmitari F.K., në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se punon në kompaninë ‘’ ‘’ që nga viti 2011, dhe në bazë të kontratës së punës kujdeset për të hyrat dhe të dalurat e mjeteve financiare në kompani, por edhe me punë të tjera që delegohen nga punëdhënësi i kompanisë. Ne rastin konkret për punë të tjera që kryen nga punëdhënësi, merret me shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve në punë, ku siguria dhe shëndeti në punë është obligim nga institucionet gjegjëse që çdo kompani të merret për shëndetin dhe sigurinë duke angazhuar Kompani dhe ekspert të licencuare për vlerësimin dhe eliminimin të gjitha rreziqeve të mundshme që mund të ndodhin në kompani. Secili punëtor i ri që ka filluar punën në kompaninë tonë trajnimin e tyre e ka bërë kompania ‘’ ‘’, dhe në fazën kur ka përfunduar vlerësimi, trajnimi është bërë nga unë. Për punëtorin B.A., që ka marr lëndime në vendin e punës, trajnimi është bërë nga unë siç e cekta me larte, për trajnim të punëtorëve si dhe për mirëmbajtjen, këshillimet dhe rekomandimet, kam licencë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, siç më kujtohet nëse nuk gaboj jam licencuar në vitin 2019, por data nuk më kujtohet pasi që ka qenë një trajnim faza faza. Licenca është e lëshuar si ekspert për Shëndetësi dhe Siguri në Punë, ku nuk më ndalohet me mbajt trajnime me punëtorë. Trajnimi për punëtorin B.A.n ka qenë një (1) ditë. Por nuk e di se a duhet të jetë më shumë se një ditë, por kompania që e ka bërë trajnimin ka qenë një (1) ditë. Kompania ‘’ ‘’, nuk e ka trajnuar B.A.n, pasi që ai ka filluar punën me 26.06.2020 e kompania ‘’ ‘’, e ka përfunduar me herët ciklin e trajnimeve. Unë për ditën të cilën e kam trajnuar punëtorin B.A., temë e trajnimit ka qenë njoftimet e mundshme në vendin e punës si punëtorë fizik, nga na ime nuk ka pas lëshime sa i përket lëndimeve që i ka marr në vendin ku ka ndodh ngjarja, arsyetimi është se për faktin se ka pas trajnim një (1) ditë është i njoftuar për rreziqet anashkalimin e tyre, si dhe masat që duhet të merren në rast se vëren diçka. Para se të vendosen detyrat e punëtorit në firmë, e nënshkruan kontratën, mban trajnim për rreziqet e mundshme, pajiset me mjetet e nevojshme mbrojtëse të punës, helmetë, këpucë, veshje dhe i caktohen detyrat e punës dhe e fillon punën. Ne çdo vend punishte ekziston një kryepunëtorë (mbikëqyrës) dhe në rastin konkret ka pas, dhe atë ditë të ndërmarrja jonë ka qenë I.R.. Unë siç e di B.A., është punësuar në ndërmarrje si punëtor fizik, pastrimin e oborrit të ndërmarrjes si dhe punë të tjera teknike, pra kryerja e punëve fizike dhe detyrave shtesë sipas nevojës që paraqiten nga kompania, për punë të tjera që ka kryer nuk mund të përgjigjem se ka pas tjetër mbikëqyrës. Kur të behet trajnimi njoftohet

punëtori për rreziqet, lëshohet procesverbal që dëshmon se punëtori në fjalë ka mbajtur trajnime si dhe nënshkruan një deklaratë ku pajtohet që është i njoftuar për rreziqet e mundshme në kompani. Kur të behet trajnimi nga kompania që personalisht unë i bej një punëtori i bëjë procesverbal dhe deklaratë që ka mbajtur trajnime dhe është i njoftuar për rreziqet që mund të paraqiten në punë, përveç punëtorit B.A., kam trajnuar edhe punëtor të tjerë që kanë ardhur mbrapa fazës kur ‘’, ka përfunduar trajnimet, ku të gjithë punëtorët janë pajisur njësoj me procesverbal dhe deklaratë që kanë përfunduar trajnimin 1 ditë brenda kompanisë.

I pandehuri Sh.A., në shqyrtimin gjyqësor, ka deklaruar se është drejtor i kompanisë “ SHPK “ me seli në Ferizaj dhe është përgjegjës i gjithë fushë- veprimtarisë së kësaj kompanie, pra është përgjegjës edhe për punëtorët që punojnë në kompani pavarësisht prej detyrave të punëtorëve. Punëtori B.A., ka punuar në kompaninë time dhe për secilin punëtor keni marrë masa të sigurisë të punëtorëve në punë (pajisje, vegla , mjete mbrojtëse etj.) dhe janë të trajnuar dhe pas trajnimit nga kompania janë pajisur me certifikata, por jo nga kompania jonë, por nga kompania “” dhe punëtori B.A. ditën kur ka ndodh aksidenti qene i pajisur me mjete te sigurisë pasi qe çdo punëtor sipas vendit te punës pajiset me mjete mbrojtëse, por nuk ka dijeni se kompani për një ditë trajnimi se a e ka pajisur punëtorin B.A. me certifikatë. Por përveç punëtorit B.A. qe i ka marr lëndimet në vendin e punës nuk ka pas asnjë rast qe ndonjë punëtor ka marr lëndime apo ka ndërruar jete, dhe se ne gjithërë kujdesemi për shëndetin dhe gjendjen shëndetësorë të të gjithë punëtorëve pa dallim. Nëse ndodh që të lëndohet ndonjë punëtor në punë ne kemi obligim qe për çdo aksident në punë ta njoftojmë inspektoratin e punës dhe të gjitha organet tjera që janë të obliguara me ligj për njoftim, por ditën kur ka ndodh ky aksident unë nuk kam qenë në punë, por siç jam njoftuar nga punëtori- përgjegjësi I.R., e ka njoftuar menjëherë emergjencën pastaj policinë dhe pas njoftimit nga punëtori I.R. se punëtori B.A., nga lëndimet që ka pësuar është dërguar në Spitalin e Prishtinës në Emergjencë, ku kam shkuar për t’u interesuar për gjendjen e tij shëndetësore. Në vazhdim të shqyrtimit gjyqësorë në pyetjet që i janë parashtruar nga mbrojtësja e tij av. Vildane Hamit, i pandehuri Sh.A., ka deklaruar se punëtori B.A. ka pasur kontratë të punës, për punën dhe detyrat qe ka filluar të punoj në kompaninë e tyre, dhe atë me detyrat e punës punëtor fizik. Ai ka pasur 4 ditë pune deri sa ka ndodhur aksidenti, po ka pasur trajnim në momentin që ka ardhur të punoj tek ne, trajnimin për shëndet dhe siguri në pune e ka mbajtur F.K., i cili ka pasur të drejtë që të mban trajnimin pasi që ka qenë i certifikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe pas certifikimit punëtorët janë pajisur me pajisje mbrojtëse në vendin e punës dhe me këto ka qenë i pajisur edhe punëtori B.A.. Ne kompaninë tonë kemi edhe mbikëqyrës për secilin sektor. Ne pyetjen e parashtruar nga gjyqtari i vetëm gjykues i pandehuri ka deklaruar se unë ndërmarren “ SHPK “ e kam hapur ne vitin 1999, ku ne fillim ka qene NTP , kurse siç me kujtohet nga viti 2006 e këndeje është bërë SHPK, ne kryesisht merremi me tregti dhe atë importues te hekurit, armaturë te llojit te ndryshëm dhe me skrap (grumbullimin e mbeturinave) dhe i dërgojmë për eksport, ku kjo ndërmarrje ka diku mbi 60 punëtor, dhe nga themelimi deri ne këtë rast qe ka ndodhur aksidenti ne nuk kemi pasur kurrfarë problemi apo lëndim të punëtorëve që ka ndodhur nga pakujdesia e punëtorëve , për punëtorin qe ka ndodhur aksidenti nuk ka ndodhur me dashje nga ne , por ne nga ai momente kemi marr te gjitha veprimet për shëndetin e tij dhe ndihmën financiare, ku për këtë edhe vet i

dëmtuari ka njoftuar gjykatën dhe prokurorin për ndihmesën e tij. Për veprën që akuzohem un nuk e ndiej vetën të fajshëm pasi që unë si përgjegjës i kompanisë kam marr te gjitha veprimet e duhura sipas ligjit.

Në shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penale, gjykata konform nenit 7,8 dhe 361 par.1 dhe 2 të KPPK-ës, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal, profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të pandehurit, si dhe ato në favor të tij, duke iu mundësuar të pandehurit dhe mbrojtëses së tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes, dhe me ndërjegje vlerësoi çdo prove një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë: - nga dëshmia e të dëmtuarit B.A., dëshmitarët: I.R., menaxher në firmën “ “, L.E., F.D., nga dëgjimi i dëshmitarëve në shqyrtimin gjyqësor me datën 10.06.2021 A.B. ,Inspektore e punës në kuadër të Inspektoratit të punës. dhe F.K. trajnues i punëtorëve në Kompaninë “ ”, dhe nga Provat Materiale: Raporti i Oficerit 2020-CF-1032, të datës 29.06.2020, Deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit B.A., të dhënë me datë 03.09.2020 në Stacion Policor Ferizaj, dhe me datë 12.11.2020 në Prokurori, Deklarata e dëshmitarit L.E., të dhënë me datë 29.06.2020 në Stacion Policor Ferizaj, Deklarata e dëshmitarit F.D., të dhënë me datë 29.06.2020 në Stacion Policor Ferizaj, Deklarata e të pandehurit Sh.A., të dhënë me datë 22.10.2020 në Stacion Policor Ferizaj, Raport zyrtar mbi aksidentin në punë, me nr. protokolli 281/20, të datës 31.08.2020, të hartuar nga Inspektorati i punës Ferizaj, Certifikata e regjistrimit e lëshuar nga ARBK, Kontratë pune për kohë të caktuar, të datës 24.06.2020, Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Njësia e Forenzikës, të datës 29.06.2020, Fletë lëshimi me epikrizë, lëshuar nga Klinika e Anesteziologjisë dhe Mjekimit Intensiv-QKUK në Prishtinë, me nr.241/2020, të datës 29.06.2020-15.07.2020, fletë lëshimi lëshuar nga Klinika e Kirurgjisë Torakale-QKUK në Prishtinë, me numër 3648, të datës 15.07.2020-28.07.2020, Akt ekspertimi mjeko ligjor të Dr. M.G., me nr. reference, të datës 21.11.2020,Statuti i “ ” SH.P.K, të datë 18.11.2020, nga mbrojtja e të pandehurit Sh.A., Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor dhe provat të tjera që gjinden në shkresat e lëndë.

Gjykata ia fali besimin provave të lartë cekura të cilat janë nxjerrë gjatë shqyrtimeve gjyqësore ku dëshmia e të dëmtuarit dhe dëshmitarëve të larë cekur përputhen edhe me gjendjen faktike siç është përshkruar në diapozitiv të aktakuzës, bazuar edhe në provat e tjera që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale.

Gjykata ka analizuar edhe dispozitën specifike të nenit 6 të Ligjit nr.04/L-161 në fuqi prej dt.01.06.2013, për Siguri dhe Shëndetin në Punë e cila thotë: ” në kuadër të përgjegjësisë së tij, punëdhënësi detyrohet të ndërmarrë masat për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë masat për parandalimin e rreziqeve profesionale sigurimin e informatave, trajnimeve e të punësuarve për punë të sigurt, udhëzimet e duhura për përdorimin e makinerive, instrumenteve e pajisjeve dhe veglave të punës, masat për organizimin dhe

mbarëvajtjes së punës “.

Sipas vlerësimit të gjykatës mbrojtja e të pandehurit Sh.A. është e orientuar kah ikja ndaj përgjegjësisë penale duke e mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata nuk ia fali besimin deklarimit të tij se ai nuk është kryes i veprës për të cilën akuzohet, sepse ky deklarim nuk ka mbështetje në asnjë provë të vetme, për këtë gjykata gjeti se i akuzuari është përgjegjës për veprimet penale për të cilën është shpallur fajtor.

Andaj, duke u mbështetur në këto fakte dhe provat e administruara gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit Sh.A., formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale “Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës “ nga neni 358 par. 5 lidhur me parag.2 të KPRK-së.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat komforn nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethanë lehtësuese mori kujdesin ndaj të dëmtuarit B.M pas aksidentit, ndihmesë materiale për shërim, i dëmtuari nuk parashtron kërkesë pasurore juridike, dhe nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, sjellje korrekte të tij gjatë gjykimit, ndërsa si rrethanë renduese për të pandehurin mori, motivin për kryerjen e veprës, shkallën e rrezikimit apo dëmtimit të së mirës së mbrojtur, andaj të njëjtin e gjykoi si në diapozitiv të aktgjykimit me bindje se dënimi i shqiptuar është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer dhe shkallën e përgjegjësisë të akuzuarit, dhe se me këtë dënim do të bëhet risocializimi i tij dhe se do të jetë si preventivë për të dhe të tjerët të mos kryejnë vepra penale të tilla apo të ngjashme, e që është qëllimi i dënimit nga neni 38 KPRK-së.

Gjykata konform nenit 463 par 1 dhe par 2 të KPPKR-së, i dëmtuarin B.A., nga fshati, “... “, Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike i ka udhëzuar në kontest civil.

Vendimi mbi kompensimin e paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e viktimave të krimit Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

P.nr.1024/2020 me datë 08.07.2021

Procesmbajtëse

Anita Zefi

Gjyqtari

Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.